

Xhevat Lloshi

Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit: 1819-1827
(Onufri 2012, 398 faqe).

Ndalohet publikimi a ribotimi i këtij teksti pa lejen e autorit.

Kreu 10

PËRKTHIMI I PARË I SUKSESSHËM

Përballë një teksti të botuar parësore është të zbulohen përpjekjet e autorit për të ndërtuar një tekst të qëndrueshëm, me koherencë e kohezion siç thuhet sot, për të përballuar detyrën kulturore, për të cilën autori i është përveshur një teksti të shkruar në një kontekst të caktuar.

Pas alfabetit, çështja themelore para përkthimit të Dhiatës së re ka qenë karakteri i gjuhës që do të përdorej. Cila do të ishte shqipja e përkthimit? Përkthimin e bëri Vangjel Meksi, të cilin e takoi përfaqësuesi i Shoqërisë Biblike, Robert Pinkertoni, dhe nënshkroi me të marrëveshjen për përkthimin më 1819; më 1820 puna në dorë të parë ishte përfunduar dhe mbetj ta rishikonte një redaktor, siç ishte praktika e pandryshueshme e Shoqërisë Biblike. Atëherë pyetja është: cila ishte gjuha e folur nga Vangjel Meksi? Ai ishte nga fshatrat e Gjirokastrës dhe kjo është pikënisja për të diskutuar të folmen e tij. Por ai ka jetuar në oborrin e Ali Pashës dhe është ndikuar nga çamërishtja dhe nga arbërishtja e Greqisë, pra nga bashkatdhetarët, me të cilët komunikonte në babiloninë gjuhësore që e rrethonte në pashallëk. Megjithatë, faktori vendimtar ishte detyra që kishte përpara për të dhënë *një variant të shkruar të shqipes*. Përveç kësaj, përkthimet biblike deri në ditët tona detyrohen të ndjekin origjinalin, prandaj për sintaksën kanë ndikime të mëdha nga struktura e greqishtes ose e latinishtes së shkruar. Nuk do të harrojmë edhe praninë e dygjuhësisë së përditshme të shqiptarëve të Janinës, madje nganjëherë edhe të trigjuhësisë: shqip, turqisht e greqisht.

Parateksti letrar stilistikisht i përpunuar e i pasur, siç është ai i Dhiatës, i kërkonte një punë krijuese Meksit si përkthyes, që për herë të parë të jepte një tekst kaq të gjerë të shqipes së shkruar. Ndërkaq, përfaqësuesit e Shoqërisë Biblike përpiqeshin të gjenin njerëz, të cilët të ishin të besueshëm me punën e tyre, dhe për përkthimin shtronin kërkesën, që gjuha të ishte e kuptueshme për një masë sa më të gjerë lexuesish. Që në provat e para ata bënë verifikime dhe gjenin njerëzit për një rishikim të kujdesshëm, madje edhe pas botimit e vijonin verifikimin për shkallën e të kuptuarit të tekstit. Kjo ishte një punë e mirëfilltë filologjike. Produkti përfundimtar del kështu me disa shtresa; unë do të kufizohem këtu me të dhënat dokumentare ndihmëse dhe me disa vëzhgime nga libri i parë i Mateut.

Dëshiroj të ritheksoj, se ky është tekst i gjuhës së shkruar, i një gjuhe të përpunuar për nevojat e përshtatjes së përkthimit ndaj origjinalit, me të cilin do të botohej paralelisht, si dhe të redaktuar pastaj, kështu që nuk mund të përfaqësojë një të folme të mirëfilltë në kuptimin dialektologjik, por bën pjesë në historinë e shqipes së shkruar.

Që në pikën e parë të marrëveshjes më 1819 theksohej se përkthimi do të jetë në shqipen, *ashtu siç flitet në Janinë*, dhe ritheksohet, që *të jetë e saktë e në përputhje me*

idiomën e shqiptarëve, ashtu siç flitet në Janinë dhe e lehtë për ta kuptuar njerëzit, për të cilët destinohej. Të gjitha këto janë kërkesa për një gjuhë të lëvruar, të përpiktë e të kuptueshme, sa më të përgjithësuar. Por është befasuese që e folmja e Janinës merret si model i një farë koineje të shqipes. Ishte koha e Ali Pashës dhe personaliteti i tij i fuqishëm ka përfutur pikërisht në qendrën e pashallëkut idenë e një modeli për një gjuhë të përgjithësuar shqipe të shkruar. Për të gjitha kombet, shtysat objektive historike, që i kanë çuar te gjuha e shkruar, kanë qenë ose kërkesat administrative dhe ekonomike të shtetit të përqendruar, ose të fesë, ose të dyja bashkë. Pastaj zgjedhjen e realizojnë njerëzit e kohës, që zotërojnë magjinë e shkrimit. Shqipja e Janinës gjeti Meksin, ashtu si në gjysmën tjetër të po atij shekulli shqipja e Elbasanit do të gjente Kristoforidhin.

Këtu bëhet fjalë për shtresën e ngritur të shqiptarëve si lexues, receptues, dhe të zbatuar prej shqiptarësh nga më të zotët si prodhues të tekstit, pra jo për një gjuhë të folur të palëvruar. Ishte një përpjekje për një gjuhë letrare të shkruar. Kemi të bëjmë me një tekst të gjuhës së shkruar, sepse sintaksa e leksiku e shquajnë gjuhën e lëvruar, ndërsa drejtshkrimi është një punë e standardizimit të ngadaltë. Numri i botimeve shqip, që mund të gjendeshin e të përdreshin lehtë në atë kohë ishte aq i kufizuar, sa dikush edhe mendonte se ky ishte i pari libër shqip. Më tej, për shkak të redaktimit, kjo do të thotë se në gjuhën e librit ka disa ndryshime, gjithnjë brenda së folmes jugore, duke kaluar nga labërishtja te gjendja e të folmeve arbëreshe, por si mbishtresime. Kështu shpjegohet përse studiuesit kanë mbajtur qëndrime të ndryshme gjatë përcaktimit të veçorive dialektore të veprës.

Nuk do të trajtoj gabimet, të cilat vijnë për shkak të mbështetjes te shkronjat e greqishtes për të shkruar shqipen; madje përballë kësaj gjendjeje, transkriptimi me alfabetin e sotëm paraqet ndërlikime. Prania e madhe e gabimeve shkrimore nuk lejon, që të bëhen shqyrtime të përpikta për fonetikën dhe për morfologjinë. Sintaksa, siç u vu në dukje, është nën ndikimin e fortë të origjinalit greqisht. Për këto arsye, brenda këtyre rrethanave, më është dukur se zgjidhja më e pranueshme do të ishte përqendrimi te leksiku.

Shtratin leksikor të kësaj vepre shqip e ka përcaktuar Vangjel Mexsi.

Para së gjithash, e vlen të vihet në dukje se ai ka treguar për kohën një njohje të jashtëzakonshme të leksikut të shqipes. Po përmend disa shembuj fjalësh, të cilat edhe te përkthyesit e sotëm rrallë i hasim, ndonëse janë pjesë me vlerë e leksikut të shqipes: *besëpakë, citoj* (shtoj, vë sipër), *çdofarë, çutëj* (i mbush mendjen), *delmer, dergjem, derrar, dëshirim, fark, fëjeje, gjëmuar, kaçup, kthjell, kurm, mbath* (sepse sot edhe për këpucët shkruajnë *vesh*), *mbjellës, mbloj, mbrëmanet, i mbrodhit, murriz, ndrit, pameta, i paqëtë, pëqi, pikëllim, qindës, shtruara, shuplakë, tatë, ushtër, ve* (mjerë).

Këtu është vendi të paraqiten edhe fjalë, të cilat mendoj se janë neologjizma të Meksit: *agjëror, arkëzë* (për: hambar), *dreqësi, humbí* (vend ku humbet), *mbjellës* (bujk), *mburrëcar, mburrëci, ngrënës* (llupës), *pagëstar* (pagëzues), *pirak* (pijanec), *qindës, qytetas, rrëmbees, shkrees, trembarak, trimshor*. Një argument, që këto janë neologjizma, është se Grigori shumicën i ka mënjanuar gjatë redaktimit, domethënë nuk i ka parë si fjalë të njohura përgjithësisht. Grigori ka hequr gjithashtu një varg fjalësh me prapashtesa zvogëluese, të cilat jo vetëm janë në vetvete të goditura, por në disa raste u përgjigjen fjalëve me prapashtesa zvogëluese edhe në tekstin greqisht, edhe në përkthimin e G. Diodatit, për pasojë, Mexsi e ka pasur më mirë që i ka shtënë në tekstin

shqip: *arkëzë*, *peshqth* (pescetti), *qenth* (cagnolini), *shtëpizë* (cameretta), *trimth*. Por *vashëzë* e ka mbajtur edhe Grigori, sepse është përdorur me kuptimin e virgjëreshës.

Veçoria e parë befasuese e këtij leksiku është se ai tregon, që Meksi nuk është mbështetur vetëm te një tekst në greqishten e re, por edhe në përkthimin italisht, të quajtur të Diodatit. Calvinisti Giovanni Diodati (1576-1649) ishte teolog italian nga Zvicra, profesor i hebraishtes e i teologjisë. Përktheu Biblën italisht më 1603 dhe e botoi të përmirësuar më 1607. Ky ishte një variant protestant dhe është krejt e mundshme që Meksi do ta kishte gjetur për ta përdorur. Vërtetimin e këtij hamendësimi e gjej te disa raste, por po sjell vetëm një. Te 8:30 Meksi 20 e ka një *greq derrash*; te 26:31 e ka *dhëntë e gregjit*; Diodati i ka *gran branco di porci* dhe *le pecore della greggia*, ndërsa Vulgata e ka pikërisht *grex porcorum* dhe *oves gregis*. Grigori 1827 i ka bërë *kope nga shumë derra* dhe *dhëntë e stanit*.

Shembujt nuk lënë dyshim, që Meksi ka shfrytëzuar përkthime perëndimore, kryesisht Diodatin dhe, ndoshta, ndonjëherë edhe Vulgatën ose ndonjë variant frëngjisht. Si mjek ai kishte mësuar diçka latinisht në Napoli përveç italishtes, ndërsa më 1814 kishte dëshmuar një njohje të kënaqshme të frëngjishtes.

Veçoria tjetër befasuese e këtij leksiku është se ka gjurmë të njohjes së gegërishtes nga Meksi. Shembulli i mësipërm nga burime perëndimore (dhe jo vetmë ai) i përket njëkohësisht edhe gegërishtes, si e dëshmon prania e tij në po atë kontekst të Buzuku: *greqj* (te Buzuku *grigj*), *këshill* (te Buzuku *kshill*), *shenjë* (te Buzuku *shenj*), *shërbëtor* (te Buzuku *shërbëtor*). Prandaj i ka mënjeluar Grigori, që nuk i ka njohur, por shpjegimi është se përkthimet gegërisht nisësin nga tekste latinisht ose italisht, siç është nisur edhe Meksi prej tyre. Tërheqin vëmendje të veçantë dy raste. Së pari, fjalën *kaptirë* për kreun e një libri, Grigori e ka zëvendësuar rregullisht me *krie*. Duket qartë, që Meksi i ka bërë toskëzimin fjalës së gegërishtes *kaptinë*, mirëpo te cili libër e ka parë këtë? Së dyti është lidhëza *domethënë*, e cila del si togfjalësh në titullin e botimit 1827. Mirëpo brenda në tekst Grigori nuk e ka pranuar; te Meksi (9:13) *ç domethënë këjo fjalë* Grigori e ka zëvendësuar me *ç është*, ashtu si në origjinal greqisht. Çështja qendrore këtu është se kemi të bëjmë me trajta të marra nga gjuha e shkruar, atëherë shtrohet pyetja: çfarë tekstesh të shkruara gegërisht ka njohur Meksi? Kam kontrolluar librat e botuar shqip deri më 1820 dhe nuk më del fjala *kaptinë*; autorët e vjetër e kanë latinisht/italisht. Mendoj se në Janinë kishte njerëz që flisnin gegërishten, madje edhe mund ta shkruanin.

Dorëshkrimi i Meksit ka gjithsej rreth 1270 njësi, por meqë 107 fjalë të tjera dalin te Grigori në faqet që i mungojnë dorëshkrimit, ky i fundit do të ketë pasur jo më pak se 1350 fjalë. 1070 fjalë të dorëshkrimit janë edhe në botim, i cili ka 1290 fjalë. Dhiata e re në origjinal ka afër 4800 fjalë. Ungjilli i Mateut si vëllim përbën një të tetën e saj, ndërsa del se shqip kemi aty gati 30 për qind të leksikut të përgjithshëm të veprës, domethënë është e pritshme që po të nxirret fjalësi i gjithë librit, do të dilte një numër më i madh se 4800 te origjinali. Cilat janë arsyet?

Burimi i parë dhe kryesor që shpjegon pasurinë leksikore të këtij përkthimi gjendet te shoqërimi i një fjale me sinonime ose me shpjegime dhe parafrazime, më të shumtën e herëve në kllapa. Sipas kriterëve të Shoqërisë Biblike kjo gjë ishte e ndaluar, sepse çonte në një lloj komentimi, si një ndërhyrje ndërmjet tekstit dhe lexuesit. Jam i mendimit se kjo dukuri ka disa shpjegime.

a. Në radhë të parë, kjo shfaqet kur leksiku i gjuhës së shkruar nuk është ngulitur përfundimisht dhe sipas një norme të përcaktuar. Vetë autori nuk është i sigurt se cila

fjalë do të jetë më e njohur, më e kapshme nga lexuesit. Për Meksin kjo është krejt e kuptueshme, po të mbajmë para sysh se po përgatiste të parin libër me këto përmasa të shqipes së shkruar mbi bazën e toskërishtes. Me këtë zgjidhje i kanë kapërcyer pasigurinë edhe autorë të tjerë shqiptarë mjaft vite më vonë në ato rrethana të lëvrimit të shqipes së shkruar. Po kufizohem me një shembull pothuaj një shekull më vonë nga A.Z. Çajupi, i cili e kishte kështu titullin e një prej fabulave të përkthyer: *Kokoshi (gjeli) dhe margaritari*, ndërsa pastaj vijonte: *Një gjel, kokosh a këndes*. Po kështu e ka bërë në raste të tjera: *Anët e trupit dhe mullëza (stomaku)*. *I dehuri (carhoshi) dhe gruaja e re*.

b. Shpjegimi i dytë është se Meksi e dinte mirë, që teksti do t'i nënshtrohej redaktimit dhe prandaj ka lënë zgjidhje alternative, të cilat do t'i përcaktonte përfundimisht redaktori.

c. Shpjegimi i tretë përfshihet në veçorinë e përgjithshme të përkthimit nga Meksi. Synimi i tij ishte që teksti të kuptohej më mirë nga lexuesit, prandaj nuk i është përmbajtur përkthimit rreptësisht fjalë për fjalë në përputhje me origjinalin. Ai ka shtuar në tekst fjalë e fjali, që nuk i kishte origjinali, duke mos iu përmbajtur kriterëve të Shoqërisë Biblike. Te 10:35 e kishte *të ndaaj njerinë (të birë) kondrë së i atit*. Fjala në kllapa është shpjegim për fjalën përpara saj, konkretizim në kundërvënien: i biri kundër të atit, mirëpo teksti greqisht e kishte vetëm “njerinë”, për këtë arsye Grigori e ka fshirë. Rrjedhimisht, në disa raste **ky është një përkthim i lirë**, por kjo i ka dhënë pasuri gjuhës së tij, e ka bërë më tërheqëse, e ka bërë më të afërt me gjuhën e folur. Ishte diçka e pritshme nga një përkthyes, i cili nuk ishte klerik, nuk e ndiente se po shkelte dogmën, nuk kishte arsim teologjik të posaçëm, shkurt, e shihte veten si një përkthyes përgjithësisht, jo të specializuar për këtë fushë me kërkesa krejt të veçanta.

Formulën e njohur “Ati ynë që je në qiell” Kristoforidhi e ka *Ati ynë që je ndë qiejt, u shënjtëroftë emëri yt*, me dallime vetëm drejtshkrimore nga përkthimet e sotme. Grigori e ka: *Jati inë që je mbë qiell, qoftë shëntëruarë emëri it*. Kurse Meksi e ka dhënë 6:9. *Tata inë që jee ndë qiell (që rrii më lart se qiellat) qoftë lëfduarë emëri it*. Është mjaft e çuditshme, se ku e ka gjetur ai shtesën “se është shkruarë ndë psaltir” (4:6), përndryshe kjo është dëshmi e fortë, që ai nuk i dinte edhe aq mirë punët e teksteve biblike dhe kujtonte se cilido prej tyre mund të quhej psaltir.

d. Shpjegimi i fundit është se Meksi nuk e ka rishikuar vetë dorëshkrimin tërësisht pas përfundimit.

E vlen të dëshmohet në mënyrë më të plotë zgjidhja nëpërmjet sinonimeve. Prej tyre po sjell disa, si çifte sinonimike në tekst ose duke u vënë njëri prej tyre në kllapa:

adhinato (e pamundurë); *arkëzë* (hambar); e *u bë* (ngjau); *çuditejnë* e liijnë mëntë; *doli* (leu) dielli; (*ndë të dukurit* e pëllumit) posi pëllum; të *dheksjë* e të presë; *eleismë* (të të vijë helm); *fiti* (veshtë); *nd'u bëftë hrii* edhe *ndë u dashtë*; *idhisi* (haber); *kakollojis* (shaan); *kallës* (ushtërë); (*katafronisni*) e përqeshni; *këcietë* (luajtitë valle); nga fjalët e tua do të *kolasësh* (mundonesh); më pak do të *kolasenë* e do të mundonenë; *kurmi* (mishtë); *u lëshuanë* (u vërsulë); e *të ligut* (e të paudhit); *lutij* e falii; *mbjellësit* (bujkut); *mbrëmanet* (natë); *u metamorfos* (ndërroi të parëtë); *miho* (kurvjar); u bë këtë *milet* (farë njeriut); *modh* (shinik); të *moloisjë* e të rëfejë; ngaha *murrizatë* e trivolëtë; *grua të ndarë* të lëshuarë; *nxier* (përmbëjedh); ta *xjerrimë* (kërrejëmë); *të pastruarë* (të stoliturë); *prapa* (pas); *me pazaar* (me pagë); *pirgo* (kullë); *qiriksnë* e rrëfejë; i *skorpis* e i dërmëhas; *ndë skotadh*, *ndë errëcirë*; *çfaqenë* (dukenë); *shkreesitë* (grammatikotë); për të

çpërblierë (për të këmbierë); e *tund* (e kolandis); *thavmaturgji* e çudi; *thavmaturgji* (nishanë); *votridha* (kopica); i *veenë* (i shtienë) jashtë; *vuri* (fitepsi); e *vuri shtruara* (e qëndroi); *me di zëmëra* (poliandhisi).

Shembuj shpjegimesh e parafrazimesh: *të sëmurë prej bëtajie* (të dhemonisurë); doi mua (*për dashuri time*); atë që më kee (*borçinë*); dhurëti (*të dhëna të mira*); fajtorë (*ju që bëjetë fajetë e anomitë*); mba'atë kohë *ahiere kuur*; kini fark (*jini më të nderçurë*); (*soa të njerëzet të këqij*) millet të keq; që kish me vetëhe (*viijnë me të bashkë*); grua të ndarë të lëshuarë (*me burrë të vee të gjallë*).

D. Libri doli në dy gjuhë paralelisht dhe ishte përkthim nga greqishtja. Është krejt e kuptueshme, që së pari përkthyesi do të ishte nën ndikimin e fortë të tekstit greqisht. Për më tepër, krahasimi tregon se Grigori e ka bërë redaktimin duke e sjellë tekstin shqip më afër me origjinalin, domethënë me greqishten, dhe kjo ka ndikuar te leksiku drejtpërdrejt. Së dyti, Meksi dhe Grigori jetonin në një mjedis dy- dhe trigjuhësh, madje në rastin e gjuhës së shkruar përparësinë kulturore e kishte greqishtja. Së treti, vetë shqipja nuk e kishte arritur një shkallë të lartë lëvrimi dhe nuk kishte asnjë tekst kaq të gjerë në variantin e shkruar toskërisht para tyre. Së fundi, ka ndikuar edhe njohja gjuhësore vetjake që kishin, ndonëse Grigori ndodhej në kushte më të privileguara, sepse tashmë e kishte një zgjidhje para vetes pikërisht për atë tekst.

Përpara se të trajtohet kjo pikë, çështja qendrore është të dallohen greqizmat, si fjalë që i ka përvetësuar shqipja, nga fjalët greke, të cilat (me përjashtim të kushteve të dygjuhësisë) as në atë kohë dhe as sot nuk gjejnë vend në shqipen e shkruar. Si konkretizim po përmend dallimin e qartë ndërmjet greqizmit *akoma* dhe fjalës greke *elpidhë*. E para bën pjesë në leksikun e shqipes; e dyta as ka qenë dhe as është pjesë e shqipes. Edhe Kristoforidhi më 1860 e kishte vënë re, se ndeshej një përzierje mjaft e rëndë me fjalë prej greqishtes së re, që vështirë se mund të kuptoheshin nga vendësit e mirëfilltë të Shqipërisë.

Pas këtij dallimi, del se dorëshkrimi dhe botimi kanë të përbashkët afër 45 greqizma, ndërsa kanë mbi 105 fjalë greke të përbashkëta. Grigori ka hequr rreth 45 fjalë greke, por ka shtuar afër 40 të tjera, kështu që secili ka afër 200 greqizma dhe fjalë greke së bashku, domethënë rreth një të gjashtën e gjithë leksikut. Interesante janë fjalët, të cilat Meksi i ka shqipëruar përgjysmë: *dorëkuc*, *monosy*, *protoparë*, *i panom*; Grigori ka pranuar prej tij vetëm *ksenderoj* dhe vetë ka ndërtuar sipas këtij kalkimi: *kseshpërblim*.

Nga ana tjetër, Meksi ka 40 fjalë greke, të cilat i ka hequr Grigori. Fakti që këto njësi Grigori i ka hequr vërteton, se janë fjalë që edhe në atë kohë nuk i përkisnin shqipes. Mënyrat se si i ka mënjeluar janë disa: thjesht i ka fshirë, sidomos kur kanë qenë në çifte sinonimike; i ka zëvendësuar me të tjera fjalë greke ose greqizma dhe ajo që ka më shumë interes, i ka shqipëruar. Shembujt për këto jepen më poshtë te puna e Grigorit.

E. Tek të dy autorët dalin 26 turqizma të përbashkëta: *baba*, *bara*, *borxh*, *çifut*, *haber*, *hajde*, *hambar*, *haraç*, *hasm*, *kamxhik*, *killë*, *kollaj*, *kurban*, *milet*, *nishan*, *pazar*, *sebep*, *siri*, *soj*, *shëndan*, *shinik*, *tallaz*, *torbë*, *i zahmetshëm*, *zinxhir*, *zurna*. Grigori i ka dyfishuar me afër 30 të tjera.

F. Shqyrtimi i hollësishëm i gjithë dorëshkrimit, duke e nxjerrë të plotë fjalësin e tij do të sjellë të dhëna të tjera, do të përvijojë më gjerësisht kriteret e përkthyesit, njohjen e traditës dhe shfrytëzimin e saj. Përpjekjet e ndryshme për ta bërë më të kuptueshëm tekstin, duke u larguar nga origjinali, do të kishin si pasojë që dorëshkrimi të ishte më

afër gjuhës së zakonshme, ndërsa teksti i botuar më i lëvruar, por ndonjëherë edhe më artificial. Shembuj prej gjuhës së gjallë ka ndër ata që janë dhënë më sipër.

Duke i rrokur me një vështrim të përgjithshëm të gjitha sa u thanë, jetën dhe formimin e Vangjel Meksit, udhëtimet e kontaktet, punën për shqipen dhe përpjekjet e vetëdijshme për ta njohur edhe si sistem, atëherë kemi të drejtë të pohojmë se dorëshkrimi i tij na shfaqet me një gjuhë sidoqoftë me karakter më të përgjithësuar e të përpunuar, me vulën e stilit të tij si përkthyes, pavarësisht prej të metave e gabimeve të përligjura në kontekstin e kohës. Dorëshkrimi i tij përftoi një vepër të botuar, një dokument të gjerë për një gjuhë të punuar e të pasur, vlerën e të cilit me të drejtë e kanë çmuar studiuesit për gjithë gjuhën shqipe në tërësi.

Para së gjithash do të vë në dukje, se Grigori e ka redaktuar dy herë Mateun, më 1824 mbi dorëshkrimin e Meksit dhe më 1827 mbi botimin e vet. Do ta pranojmë se ai ka qenë kërkues edhe ndaj vetes, sepse shihet qartë, që i ka ndrequr të metat e gabimet, të cilat kishin dalë herën e parë, dhe me këtë përvojë i është përveshur redaktimit të gjithë veprës, që e ka arritur për një kohë vërtet të shkurtër. Ndryshimet që i ka bërë botimit më 1824 nuk janë themelore, ka prekur pak fjalë e ndonjë ndërtim dhe sidomos ka përmirësuar gabimet.

Ndërkaq, për të qenë i drejtë, nuk mund të mos e vë në pah, se gabimet e përkthyesit nganjëherë e çorientojnë edhe redaktorin. Kështu, te 7:23 Meksi kishte shtuar si koment *juu fajëtorë (ju që bëjë të fajetë e anomitë)*, ndërsa gjatë redaktimit Grigori e ka hequr shtesën dhe ... i ka humbur për vete fjalë e nevojshme *ikëni ngaha meje*.

Duke kaluar te botimi i plotë, çështja e parë me interes është vetë titulli i librit. Na mungon një titull për gjithë veprën nga Meksi. Dorëshkrimi hapet me *Të kthyerit e Shënt Mattheut Evangjelistiut*, ndërsa kur vjen radha me ungjillin pasues del *Shënti ungjill i Evangjelistiut Markosë*.

Më 1827 Grigori i është përshtatur greqishtes *Shenti Ungjilli i Mattheosë*, duke ndjekur rendin e greqishtes. Më pas ka vijuar njësoj *Shenjt i ungjilli i Markosë*. Përfundimi besoj është, se Meksi do të ketë dhënë ndonjë variant të titullit të përgjithshëm, pastaj kanë ndërhyrë në këtë pikë jo vetëm Grigori, por edhe të tjerë shqiptarë, me të cilët është këshilluar.

Përgjithësisht, redaktori ka përparësinë se e gjen një tekst të gatshëm, i gjen shumicën e problemeve të zgjidhura, mëdyshjet të sqaruara ose të dhëna me alternativa, shkurt, ecën në një rrugë tashmë të shtruar dhe e ka më të lehtë të bëjë hapa të tjerë përmirësimi të mëtejshëm.

Detyra e parë e Grigorit, përballë përkthimit të Meksit - në disa raste të lirë, me shtesa e komente, me gabime e me rënie, - ka qenë që ta sillte më afër në përputhje me origjinalin greqisht. I. Laundzi (Lowndes), përgjegjësi i Shoqërisë Joniane, që e realizoi gjithë botimin e veprës, e ka shprehur qartë: "Kryepeshkopi Grigor i ka kushtuar shumë vëmendje rishikimit të dorëshkrimit, me qëllim që t'i shëmbëllej greqishtes pa shtesa ose ndryshime dhe banorët nga Shqipëria e kuptojnë".

Puna konkrete e Gjyrokastritit si redaktor atëherë ka qenë ta përpunojë dorëshkrimin në disa drejtime.

A. Në radhëtë parë dorëshkrimi është shkarkuar nga fjalët e fjalitë e shtuara prej Meksit.

B. Puna tjetër kryesore nëpër gjithë tekstin ka qenë të zgjidhej njëri prej sinonimeve dhe të hiqeshin komentet, shpjegimet e parafrazimet sinonimike.

C. Nuk duhet kujtuar sikur Grigori thjesht ka hequr e fshirë, sepse i ka mbajtur disa prej sinonimeve e parafrazimeve të Meksit, si: *mbjellësit* (bujkut); *kallësë* (ushtëra); *vuri* (fitepsi); *fiti* (veshtë); *idhisi* (haber); *u metamorfos* (ndërroi të parëtë); bënetë *miho* e kurvjar; *pirgo* (kullë); *modh* (shinik); *doli* (leu) dielli; ndë *erësi* edhe ndë skotadh. Ka mbajtur madje edhe ndonjë shtesë të Meksit kundrejt tekstit dhe për këtë do të mjaftonte rasti me formulën shumë të njohur: *Bukën tonë të përditshme jepna sot*. Meksi i kishte shtuar: *që na duhet për fis tënë* dhe e ka mbajtur gjithashtu Grigori (!)

Nën ndikimin e kësaj zgjidhjeje të zbatuar prej Meksit, edhe vetë Grigori e ka ndjekur këtë rrugë, domethënë duke shtuar sinonime e kllapa nga ana e vet. Rrjedhimisht, si Kristoforidhi, i cili njihte vetëm botimin dhe e kishte vënë re më 1860 se teksti kishte mjaft parafrazime e në disa vende ishin lënë jashtë fjali të tëra, ashtu edhe punonjës biblikë më vonë, kanë pasur lëndë ku të mbështeteshin për vërejtjet e tyre, sepse ishte shkelur kriteri i Shoqërisë Biblike për të mos bërë ndërhyrje dhe komente në tekstin e përkthyer.

Pavarësisht prej të metave të kuptueshme, të dy autorët kanë dëshmuar një njohje të gjerë të sinonimisë së shqipës, Vangjeli së pari duke vënë pranë dy sinonime, Grigori duke përzgjedhur njërin ose edhe duke gjetur një sinonim tjetër. Që të dyja këto të fundit, edhe përzgjedhja, edhe gjetja e re janë dëshmi të kompetencës gjuhësore po aq sa edhe gjetja e çifteve sinonimike.

Që të dy, ashtu si më pas Kristoforidhi, i kanë shtuar disa fjalë ose për të ruajtur ndërtimin e fjalive sipas natyrës së shqipës, ose për të mos u keqkuptuar teksti. Me terminologjinë e sotme, disa raste të tilla janë "përkthim brenda gjuhës", që të sigurohet kuptimi i drejtë, diçka e natyrshme për një gjuhë letrare të re dhe për mendësinë shqiptare, të patransformuar rigorozisht në gjuhën e vet sipas botëvështrimit të një feje të vetme, madje me mbeturina pagane.

D. Një përfundimi tjetër i përgjithshëm dhe me rëndësi për ta nxjerrë në dukje është, se gjatë punës Grigori është përpjekur jo vetëm ta afrojë tekstin me origjinalin greqisht, por edhe ku ka qenë e mundur ta përshtasë me ritin ortodoks, duke i shkelur kriteret. Te 9:35 origjinali përmend shkoqur se Krishti predikonte nëpër sinagogat dhe shpallte ungjillin, Grigori i ka mënjeluar sinagogat dhe i ka dalë *tuke dhidhaksurë ungjilln' e mbretërisë*. Meksi e kishte *e dhidhaks ndëpër sinagogët e u rëfen ungjillë*; edhe më 1824 vetë Grigori e kishte *ndë sinagogë të ture, e tuke qiriksurë*. Lidhur me këtë fjalë është edhe qëndrimi përgjithësisht ndaj termave për ndërtesën e shërbesave fetare. Në këtë Ungjill haset 15 herë termi "tempull", sepse ishte fjala për tempullin e hebrenjve, dhe kësaj i është mbajtur Kristoforidhi; këtu përfshihet vetëm një herë edhe "shenjtërore". Te Grigori haset 20 herë termi "kishë", që në origjinal është vetëm 3 herë, domethënë tempullin ai e ka dhënë për *kishë*, si dhe e ka përkthyer në *kishë* dy herë termin "altar". Është e vërtetë që edhe Meksi e ka "kishë", por dy herë më pak, ndërsa njëkohësisht ka përdorur edhe 2 herë *nao*, dy herë *iero* dhe 2 herë *meshë*. Fakti tjetër është se dy herë Grigori në togun *Zoti Krisht* e ka shtuar fjalën "Zoti" që nuk e ka origjinali, sepse kjo ka qenë praktikë e ligjëritimit ortodoks.

Kam ndeshur edhe një rast të kundërt, kur Grigori ka hequr diçka nga origjinali përballë. Nuk e di si ka ndodhur që edhe te origjinali greqisht më 1824 ka kllapa me një shtesë në 10:12, ndërkohë që edhe botime të tjera nuk e kanë, por Meksi aty kishte *qoftë paqa*. Grigori e ka hequr që më 1824,

E. Rrjedhim i drejtpërdrejtë i përshtatjes më të mirë me origjinalin greqisht është mënjanimi i rasteve të ligjërimit të folur dhe kalimi te një gjuhë më librore. Ndërsa Meksi e kishte *ju qas pirasmoi djalli*, Grigori e ka bërë *qas tek ai djalli*.

Janë veçori të gjuhës librore:

- denduria e përemrave vetorë e pronorë: *unë dërgoj ëngjëllinë tim të shkojë përpara teje, ai do të dërtojë udhënë tënde përpara teje; nga pemëtë dha të ture do t'i njihni ata;*

- përsëritja e pjesëzave, e parafjalëve dhe e lidhëzave, që në të folur bien, p.sh. *ndëpërmes të qishësë edhe të vendit; mbi re të qiellit me fuqi edhe me shumë lëvdim; do t'u përgjigjetë e do t'u thotë; të shëroni të sëmurëtë, të qëroni të leprosuritë, të ngjallni të vdekuritë, të kreni të paudhëtë*. Shembulli i fundit dëshmon se kur Meksi ka përdorur urdhëroren, Grigori i ka zëvendësuar rastet me lidhoren, domethënë në vend të *doi* e ka bërë *të doni*.

- gjuha e folur parapëlqen trajtat më të thjeshta; e shkruara përkundrazi, ato më të zgjeruarat. Kështu Meksi ka *e si iknë; e si dolli*, Grigori i ka bërë *e pasi iknë; e pasi dolli*. Por e ka tepruar me zgjerimin e numërorëve rreshtorë: *i dhjetëtë, i njëmbëdhjetëtë* etj.

- gjuha e folur parapëlqen ndërtimet veprorë, gjuha librore parapëlqen ndërtimet pësore. Meksi e kishte *ngaha ai që të kërkoi hua*, Grigori e ka bërë *atë që kërkon të huhetë nga teje*, një ndërtim tërësisht artificial.

- një varg fjalësh e shprehjesh janë tipike për gjuhën e folur dhe i ka zëvendësuar Grigori. Ja një rast domethënës: Meksi e kishte *Iisui u poq nd'udhë me to*, kurse redaktori e ka kthyer *u duall përpara nd'ato Isui*. Te Meksi ishte *e ahëre s'prishetë asnjëra*, Grigori e ka kthyer *ruhenë të dia*.

Siç është e perceptueshme, gjuha librore ka një ngjyrim artificial. Kështu e ka fjalia *nuk është ndëjerë tek ti të keç atë*, ndërsa Meksi e kishte *nukë të ndëjenetë tij të kesh atë*. Po ashtu, duke ndjekur këtë vijë, ky ligjërimit priret drejt eufemizmave. Grigori nuk ka dashur të mbetet si në origjinal, që Shën Mëria mbeti me barrë (Meksi: *të bëëritë me barrë t'asaaj*), prandaj e ka kaluar mbyturazi *se ajo që u bë në ajo*.

F. Siç e vura në dukje më sipër, shtratin leksikor të kësaj veprë shqip e ka përcaktuar Meksi. Teksti i Grigorit ka 1290 fjalë, sepse ai ka hequr 200 fjalë të dorëshkrimit dhe ka shtuar 220 të tjera. Janë rreth 80 njësi më pak, pikërisht për shkak të pranisë së shtesave e sinonimeve të Meksi, rrjedhimisht në tërësi nuk ka ndërhyrje thelbësore nga pikëpamja e leksikut të mirëfilltë të shqipes. Gjithashtu Grigori ka shtuar një varg leksemash, por jo aq të rëndësishme.

Pika kryesore në këtë rast del qëndrimi ndaj fjalëve greke, domethënë jo ndaj greqizmave, në të dy tekstet. Për mbi 40 fjalët greke të Meksi, të cilat i ka hequr, Grigori ka vepruar me disa rrugë: disa fjalë greke i ka fshirë kryesisht sepse e kishin një sinonim tjetër; disa fjalë greke i ka shqipëruar; ndonjë fjalë greke e ka zëvendësuar, por pa vlerë përmirësuese; disa i ka zëvendësuar po me fjalë greke ose greqizma. Përveç këtyre, te Grigori ndeshen greqizma të shtuara prej tij.

Nga një njehsim i përafërt del se Meksi ka rreth 14% fjalë greke dhe greqizma, ndërsa Grigori rreth 16%. Do ta pranojmë, që disa njësi leksikore ishin në ligjërimit dygjuhësh, po edhe nuk mund t'u kërkohet atyre që t'u gjenin me lehtësi barsvlerëset shqipe. Madje nëpërmjet proceseve të ndryshme dhe me trajta e kuptime të ndryshuara ka njësi që në shtresa të caktuara kanë hyrë në leksikun e shqipes.

G. Diçka e papritur është rritja e numrit të turqizmeve nga redaktimi i Grigorit. Te të dy janë të përbashkët rreth 25 turqizma. Grigori i ka dyfishuar me mbi 30 të tjera:

Shpjegimin e kësaj dukurie duhet ta gjejmë te mjedisi, në të cilin punonte Grigori. Nuk mund të harrojmë, se vërtet arbëreshët ishin mes popullsisë greke, por që të dyja bahkësitë ishin nën sundimin osman. Te Janina e Meksit gjendja gjuhësore ishte më e ndryshme për shkak të sundimit të Ali Pashës, gjendje të cilën e kam quajtur më lart një babiloni gjuhësore, sepse jo vetëm Shqipëria ishte më afër dhe popullsia arbëreshe e çame gjithandej e pranishme, por edhe lidhjet me Italinë e përgjithësisht me Europën ishin më të afërta. Grigori, përkundrazi, duket se i ruante më mirë tiparet e të folmes së Gjirokastrës, ndodhej më afër qendrës së Perandorisë Osmane, me administratën osmane të palëkundur, kurse e kundërta kishte ndodhur në Janinë. Shënon një nocion tipik të ekonomisë osmane fjala “mylk” në vend të “gjë shumë” te Meksi, afërsisht njësoj si do ta përkthente më vonë Kristoforidhi. Fjalën “fiqir” e ka në togfjalësh, që nuk janë përdorur në shqipen: *digjoi fiqir e ture; kupëtoi fiqiret e ture*. Përgjithësisht turqizmat janë e vetmja anë, që e ka ulur në nivelin e gjuhës së folur tekstin e Grigorit, si e vërtetojnë shembuj të tillë: *ç’ dert kemi na; e Iisui gjezdiste; gjan me një njeri bazërgjan*.

H. Pasuria leksikore e Meksit ia ka zgjeruar horizontin Grigorit, e ka nxitur të gjejë sinonime, të bëjë shqipërime të fjalëve greke, madje të sjellë edhe ndihmesa të vetat. Po rendis disa fjalë, që nuk i kishte Meksi dhe që duken me interes sot pas dy shekujsh: *akëcili, faqeza, lëngo, lig, matës, menjëçikëzë, nkuqet, paqcoj, i paqmë, pikëtohem, poqë, trembëlak*. Të goditura janë edhe disa shprehje të tij, p.sh. në vend të “duhet” e ka bërë *është e udhës*; në vend të “jam i butë e tapino” e ka bërë *jam i butë e i urtë në zëmër*.

I. Do të pranojmë edhe shijen vetjake të autorit. Për 14:13 ka variante të ndryshme përkthimi shqip - Meksi e kishte sipas greqishtes *veçë ndë një vend erimi*, Grigori e njihte mirë fjalën “erimi”, megjithatë e ka dhënë mjaft të goditur *e ndenji vetëmë ndë vënd që s’që njeri*. Te 7:12 origjinali e kishte: “Gjithçka pra që doni t’ju bëjnë njerëzit juve...”, domethënë te gjithçka përmbliidhen të mirat dhe të këqijat, prandaj Kristoforidhi e ka dhënë “gjithë sa të doni”, ndërsa interpretimi i Meksit ka qenë për të këqijat: *saa doi ata që t’u bëjnë juvet të ligatë, bëni edhe ju mb’ata*, kurse anasjelltas, te Grigori ka qenë për të mirat: *sa dha të mira doni të ju bëjnë juvet njerëzitë, të tila të bëni edhe juvet mb’ata*. Ndër parapëlqimet vetjake do të shënoja se parafjalën *mbë* të Meksit rregullisht Grigori e ka ndërruar në *ndë*; si dhe: *dëgjuatë* në *digjuatë*; *mbëretëri* në *mbretëri*, *Perëndi* në *Perdi* etj. Në një rast të dy janë shmangur sipas shijes së tyre për ta dhënë diçka me fuqi shprehëse – Meksi e kishte *qe të dukuritë e tij posi dbora*, më afër origjinalit, Grigori e ka çuar më tej figurshmërinë: *qe bukuria e tij posi vetëtimë*.

Redaktimi i Grigorit, duke i rrokur të gjitha këto anë, e paraqet atë me formim të tillë kulturor të shëndoshë, që ia mundësoi ta përballonte me sukses një punë, për të cilën nuk kishte pasur përvojë më parë. Ai e ka përmirësuar tekstin jo vetëm duke mënjanuar gabimet e të metat e zakonshme, por edhe duke depërtuar në hollësitë kuptimore, siç e kërkon përpunimi i një teksti me kërkesa të vështira. Meksi shkruante: *mori të pesë bukëtë e i thërrëmoi*. Grigori e ka bërë *i theu*, sepse pikërisht kështu e ka shqipja: *e thyej bukën*, në kuptimin që e ndaj për t’ua dhënë të tjerëve.

Puna e vlefshme e bërë përgjithësisht nga redaktori, nuk e përjashton që në disa raste edhe teksti i Grigorit të ketë mangësi e të meta, ose nuk ka arritur ta përmirësojë dorëshkrimin e Meksit, madje diku edhe e ka cenuar.

Para së gjithash, ka fjalë e fjali të tëra që kanë mbetur jashtë nga teksti i shtypur dhe Grigori e të tjerët nuk i kanë kapur gjatë ndreqjes së bocave.

Pa dyshim, Grigori e ka përmirësuar shqipen e tekstit, duke rregulluar sidomos ndërtimet sintaksore dhe duke i ndryshuar një varg fjalësh, domethënë nga afrimi më i madh me origjinalin nëpërmjet gjithë rrugëve, e ka bërë më të përpiktë. Po shtoj ndonjë shembull tjetër. Një fjalë e greqishtes ka dy kuptime: për kohën kalendarike dhe për motin si klimë. Meksi i kishte ngatërruar ato: *do të vijë mot kur*, ndërsa Grigori e ka ndrequr *do të vijënë dit. E ja zee ndë mergulë* e Meksit është bërë më e përpiktë nga redaktori: *një zë nga reja*. Gjithashtu *E u thonë me gënjeshtër katigorira të këqia* e përkthyesit ka dalë jo aq e qartë dhe e ngathët, ndërsa pas redaktimit është: *e t'u thonë kondrë juvet çdo fjalë të ligë*.

Përkundrazi, teksti ka humbur nga shtimi i fjalëve greke të papranishme në shqipen, si dhe nga shtimi i panevojshëm i turqizmeve.

Puna e redaktorit ka krajetat e veta, por ajo bën një hap të domosdoshëm përpara dhe u mbetet redaktimeve të mëpastajme të arrijnë një shkallë më të përpiktë e më të përsosur.

Përkthimi i Meksit ishte më perëndimor, redaktimi i Grigorit është më lindor; përkthimi i Meksit ishte më i lirë, redaktimi i Grigorit është më afër tekstit origjinal greqisht; përkthimi i Meksit ishte më afër shqipes së folur, redaktimi i Grigorit është më afër shqipes së shkruar. Dallimet ndërmjet tyre janë dallime në formimin gjuhësor dhe si personalitete. Meksi ishte mjek, laik, jo shërbëtar, njihte disa gjuhë të huaja edhe perëndimore; Grigori ishte klerik, me arsim fetar greqisht, jo me gjuhë të tjera. Meksi ishte mes babilonisë gjuhësore të Janinës, por aty edhe të tjerë kishin bërë përpjekje lidhur me gjuhën shqipe, kurse ai vetë kishte edhe përvojë si përkthyes; Grigori kishte qenë më larg mjedisit shqiptar, dhe veçanërisht larg pranisë së ndikimit venecian në Korfuz; as vetë nuk kishte mësuar e udhëtuar nëpër Europë si Meksi, përkundrazi, që në përpjekje më të afërt me sunduesit osmanë në Eube. Për fat të mirë, ai hyri në marrëdhënie me të huajt dhe me shqiptarët e përfshirë në peripecitë e Ishujve Jonianë; aty fitoi një përvojë të re, duke u marrë me përkthimin e Meksit dhe e çoi më tej punën. Ishte një përkim fatlum ndërmjet një redaktori dhe një përkthyesi, që përftoi një vepër me rëndësi në rrugën e shqipes së shkruar.

Shkëputur nga libri:

Xhevat Lloshi: Përkthimi i V. Meksit dhe redaktimi i G. Gjirokastritit: 1819-1827 (Onufri 2012, 398 faqe).

Ndalohet publikimi a ribotimi i këtij teksti pa lejën e autorit.